

L I G J I N r 8224 date 15.05.1997

NDRYSHUAR ME LIGJIN 8335 date 23.04.1998

PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISE TE BASHKISE DHE TE KOMUNES.

NENI 1.

Ne Republiken e Shqiperise prane bashkive e komunave organizohet e funksionon policia bashkiake dhe e komunes. Per degtyrat qe kryen ajo eshte ne mvartesi te kryetarit te bashkiase e te komunes.

Policia bashkiake dhe e komunes eshte organ ekzekutiv qe ka per detyre te kryeje funksione ne sherbim te rendit e te qetesise dhe mbarevajtjes se puneve publike brenda teritorit te bashkise e te komunes ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe qe nuk jane ne kopetence te autoriteteve te tjera shteterore.

Policia bashkiake dhe e komunes nuk eshte p0-jese perberese e Forcave te Armatosure.

NENI 2

Policia bashkiake dhe e komunes si rregull ka kete strukture;

- 1 . Shefi i policise
- 2 . Oficere
- 3 . Police

Prane keshillit te rrethit emerohet komandanti i policise te bashkive dhe te komunave.

NENI 3

Kryetari i bashkise dhe komunes emeron dhe shkarkon drejtuesin e policise se bashkise dhe te komunes

Drejtuesi i policise bashkiake a te komunes duhet te jete diplomuar ne Akademinde e Rendit publik. Ai kryen me autorizim te prokurorit dhe funksione te oficerit te policise gjyqesore.

NENI 4

Pranimi ne policine bashkiake a te komunes behet sipas kriterëve te percaktuara nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministri i Rendit publik.

Oficeret e policise se bashkise e te komunes kryejne me autorizim te oficerit te policise gjyqesore dhe funksione te oficerit te policise gjyqesore.

Pranimi dhe lirimi ne policine e bashkise a te komunes behet sipas kriterëve te percaktuara nga Ministri i Pushtetit vendor dhe Decentralizimit dhe Ministri i i rendit publik.

Oficeret inspektoret e policise se bashkise a te komunes kryejne me autorizim te prokurorit edhe funksione te oficerit te policise gjyqesore.

NENI 5

CFUQIZOHET

NENI 6.

Drejtuesii i policise se bashkise apo te komunes pergjigjet per kryerjen e sherbimeve te kesaj policie ne perputhje me ligjin.

NENI 7

Punonjesit e policise te bashkise a te komunes i nenshtrohen kualifikimit dhe trajnimit.

NENI 8

Policia e bashkise dhe e komunes ka per detyre

1 . Te siguroje zbatimin efektiv te akteve te nxjerra nga kryetari i bashkise a i komunes. Dhe vendimeve te keshillit qe kane te bejne me sigurimin e rendit e te qetesise dhe mbarevajtjen e puneve publike.

2 . Te marre masa per ruajtjen e pasurise se bashkise ate komunes si dhe te atyre qe administrohen nga ana e saje.

3 . Te siguroje zbatimin e urdherave te ncjerra nga kryetari i bashkise apo komunes ne lidhje me personat juridik e fizike , qe nuk plotesojne konforme ligjit detyrimet financiare e fiskale , ndaj bashkise apo komunes, si dhe cdo detyrim tjeter pasuror ndaj tyre.

4 . Te mbikqyre e verifikoje nese shtetasit ne administrim te pasurise se tyre ,zbatojne ose plotesojne kerkesat e akteve bashkiake.

5 . Te mbikqyre dhe te marre masa ndaj shtetasve ,subjekteve fizike e juridike , kur konstaton shkelje te rregullave per hedhjen, grumbullimin, largimin dhe perpunimin e mbeturinave ,dhe per mbrojtjen e mjediseve publike.

6 . Te kontrolloje, bllokoje,pezulloje dhe prishe ndertimet e paligjeshme , kur vendoset nga organi pergjegjes i bashkise apo komunes. Te ndaloje zenien e paligjeshme te trojeve,ndertesave dhe objekteve te bashkise a te komunes si dhe te organizoje lirimin e tyre. Per zbatimin e akteve te organeve te bashkise a komunes ne fushen e urbanistikes, bashkepunon me inspektoriatin shteteror te ndertimit, ne baze te akteve ligjore, nenligjore dhe marreveshjeve perkatese.

7 . Te kujdeset per aqetesine publike ,duke shmangur zeniet , menjanuar zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerezve ,autoparlaneve e radiove e manjetofoneve ,

renia pa vende e borive te automjeteve ne rruge , banesa , plazhe e mjedise te tjera publike , qe sjellin shqetesime per te tjeret.

8. Te marre masa per ruajtjen e rendit , kur ka grumbullime njerezish , si ne tregje, panaire,ceremoni publike ,artistike, fetare e sportive , ne kinema, teatro, pallate e salla sportive , objekte te kultit dhe ne mjedise te tjera publike..

9. Te inspektoje tregjet, te kontrolloje zenien e vendeve per tregeti ambulante , te verifikoje paisjen me licence te tregetareve dhe personave te tjere qe merren me veprimtari shitblerjeje , me tregetimin e pijeve alkolike , objekteve me vlere artistike e kombetare , lendeve djegese, te kontrolloje respektimin e mases ,peshes dhe cmimin e shitjes

10. Te kujdeset per respektimin e orarit te sherbimit te njesive tregetare ,bufeve ,restoranteve ,bilardove,, lojrave te fatit e te objekteve te tjera me veprimtari publike , si dhe per zbatimin e nga ana e tyre te rregulloreve apo urdherave te nxjerra nga kryetari i bashkise apo i komunes.

11. Te kontrolloje marrjen e masave te sigurise qe parandalojne fatkeqesite e ndryshme natyrore si dhe te ndihmojne ne kapercimin e tyre duke i dhene ndihme te demtuareve ne raste urgjente.

12. Te marre masa te perkoheshme ndaj te semureve psoqike ne gjendje te rende, qe krijojne shqetesime per rendin publik,

13 . Te kujdeset per ruajtjen e afisheve , njoftimeve e shpalljeve publike si dhe heqjen e atyre te paligjeshme ose te pa autorizuar.

14 . Te kontrolloje dhe marre masa per nderhyrjet e paligjeshme dhe demtimet ne rrjetin e ujesjellesit , shperdorimin e ujit te pijshem , demtimet dhe nderhyrjet ne sistemin e rrugeve dhe te kanalizimeve,

15 . Te kontrolloje dhe te marre masa per per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore , ndaj subjekteve qe ushtrojne veprimtari ne trasportet rrugore,

16 . Te kontrolloje e marre masa per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore, ndaj subjekteve qe perdorin rruget publike ne perdorim ,pronesi te bashkesise apo te komunes.

17 . Te kryeje sherbime te perkoheshme per rregullimin e trafikut ne pjese te vecanta te rrugeve dhe qendrave te banuara per nevoja te aktiviteteve te bashkise a;po komunes , te zbatimit te projekteve te sherbimeve publike dhe te komunitetit duke bashkepunuar me policine rrugore.,

NENI 9

Per rastet kur nevoitet zbatimi forcerishte i kopetencave drejtuesi i policise se bashkise apo te komunes njofton 5 mdite perpara personin e interesuar,

NENI 10

Kur gjate kryerjes se sherbimit konstatojne elemente te nje vepre penale , punonjesit e policise se bashkise apo te komunes kryejne keto detyra;

- bene perpjekje per parandalimin e pasojave te saje
- bllokon autorin ne kushtet e flagerances
- ruan dhe fikson provat ne venmdin e ngjarjes

- jep ndihmen e pare viktimave apo personave te demtuar
Perdorimi i armes nga ana e punonjesve te [policise bashkiake behet vetem ne kushtet e percaktuara ne ligjin Nr 8290 date 24.02.1998 .**PER PERDORIMIN E ARMEVE TE ZJARRIT .**

NENI 11

Punonjesit e policise se bashkise a te komunave ne zbatim te kopetencave te tyre , kane tre3 drejte te therrasin ne mjediset e policise se bashkise apo te komunes shtetasb te ndryshem qe kane shkelur dispozitat e ketij ligji,

NENI 12

Policia e bashkise a komunes bashkepunon me strukturat e mbrojtjes civile ne raste te fatkeqesive natyrore,zjarreve, permbytjeve,termeteve etj,

NENI 13

Per shkeljet e verejtura punonjesi i bashkise a i komunes kane te drejte te gjobisin ne vende personat pergjegjes ne masen 500 deri ne 5000 leke

Kundravajtesit jane te detyruar te paguajne gjoben brenda 5 diteve nga dita e dhenies,
Per cdo dite vonese gjoba paguhet me kamate 2 perqinde, Me kalimin e afatit njemujor , gjoba vilet sipas rregullave te percaktuar ne ligjin . **PER KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE .**

NENI 14

Policia bashkiake dhe e komunes ka uniformen e saje te ndrysheme nga ajo e policise se shtetit , Punonjesit e saje kane shenjen dalluese dhe numrin personal, Punonjesit e policise se bashkise dhe te komunes paisen me arme, Paisja me arme , menyra e ruajtjes dhe e mbajtjes se saje rregullohet me akte te ministrit te Brendshem,

NENI 15

Minuistri i brendshem miraton rregulloren tip te policise se bashkise e komunes,

NENI 16

Ne raste nevoje , kur cmohet e domosdoshme per ruajtjen e rendit , shefi i komisariatit te policise dhe kryetari i bashkise apo te komunes mund te bashkerendojne veprimet e policive me miratim te prefektit,

NENI 17

Numri i pergjithshem i punonjesve te policise se bashkise a te komunes miratohet nga Keshilli i Ministrave me propozim te Ministrit te Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Struktura, pagat dhe shpenzimet buxhetore jane ne kopetence te keshililit te bashkise a komunes,

NENI 18

Punonjesit e policise se bashkise a te komunes gezojne mbrojtje te njejte ligjore me punonjesit e policise se shtetit,

NENI 19

Ngarkohet Keshilli i Ministrave dhe Ministri i Pushtetit Vendor e Decentralizimit te nxjerrin akte nenligjore ne zbatim te ketij ligji,

NENI 20

Cdo dispozite qe bie ne kundersizim me kete ligj cfuqizohet

NENI 21

Ky ligj hyne ne fuqi me 15 korrik 1997,

Shpallur me dekretin Nr 1801 date 22.05.1997 te presidentit te republikes se shqiperise,

